4. Nëse kërkesa e dorëzuar për Kushte Ndërtimore nuk është e kompletuar, organi kompetent informon aplikuesin që kërkesa nuk është e kompletuar dhe kërkon nga aplikuesi plotësimin e të dhënave që mungojnë, duke u bazuar në listën kontrolluese të përcaktuar në Shtojcën nr. 5 të këtij udhëzimi administrativ.	4. If the request for Terms of construction is not completed at the moment of submission, the competent body shall inform the applicant that the request is not completed and request the applicant to supplement the missing data based on the checklist determined in Annex 5 of this Administrative Instruaction.	4. Ako zahtev o uslovima izgradnje nije kompletiran prilikom dostave, nadležni organ obaveštava podnosioca prijave da zahtev nije kompletiran i treba da traži od podnosioca prijave popunjavanje svih podataka koji nedostaju, na osnovu kontrolno spiska koji je utvrđen u Aneksu 5.
5. Nëse kërkesa për Kushte Ndërtimore është e kompletuar, organi kompetent brenda tre (3) ditësh përcjell kërkesën personave përgjegjës për shqyrtim dhe publikon kërkesën për Kushte Ndërtimore në web faqen e organit kompetent.	5. If the request for Terms of construction is completed, the competent body shall within three (3) days send the request to persons responsible for review and publish the request for the Terms of Construction in the competent body's website.	5. Ako zahtev o uslovima izgradnje nije kompletiran, nadležni organ u roku od tri (3) dana prosleđuje zahtev odgovornim licima za razmatranje i objavljuje zahtev o uslovima izgradnje na internet stranici nadležnog organa.
6. Brenda shtatë (7) ditësh nga data e pranimit të kërkesës të kompletuar për Kushte Ndërtimore, organi kompetent, paralelisht me shqyrtimin e kushteve themelore per shendet dhe siguri, në koordinim me aplikuesin:	6. Within seven (7) days from the day of receiving the completed request for Terms of construction, the competent body shall, in parallel with the review of the basic health and safety conditions, and in coordination with the applicant:	6. U roku od sedam (7) dana od dana prijema kompletiranog zahteva o uslovima izgradnje, nadležni organ će paralelno sa razmatranjem osnovnih zahteva za zdravlje i bezbednost, u koordinaciji sa podnosiocem prijave:
6.1. Viziton vendndërtimin për të cilin është parashtruar kërkesa me qëllim të vërtetimit që të dhënat e dorëzuara, janë	6.1. Visit the construction site for which the request was submitted, in order to verify that the data submitted are in	6.1. Posetiti gradilište za koju je podnesen zahtev u cilju potvrđivanja da su dostavljeni podaci u skladu sa postojećim


në përputhje me gjendjen ekzistuese, dhe që kushtet ndërtimore të propozuara i përmbushin kërkesat nga paragrafi 1 i këtij neni: 6.2. Vendos njoftim publik në parcelë dhe në rrugë publike në distancë brenda pesëdhjetë (50) metrave nga kufijtë e parcelës kadastrale për të cilën kërkohen kushtet ndërtimore ku: 6.2.1. në njoftim ceket afati kohor prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e publikimit të njoftimit për dhënjën e komenteve për kushtet e propozuara ndërtimore 6.3. Forma e përmbajtjes së Njoftimit Publik është prezantuar në Shtojcën nr. 4 të këtij udhëzimi administrativ. 7. Brenda shtatë (7) ditëve nga pranimi i komenteve, organi kompetent shqyrton vërejtjet e pranuar dhe vendos ato në ueb faqen e organit kompetent. 8. Brenda dhjetë (10) ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, organi kompetent ofron përgjigje me shkrim në të gjitha komentet e pranuar, publikon në ueb faqen e organit kompetent. 9. Brenda tridhjetë (30) ditëve organi kompetent vendos të: 9.1. Miratoj kushtet ndërtimore të propozuara nga aplikuesi;	accordance with existing state of play and that the proposed Terms of Construction fulfil the requirements foreseen under paragraph 1 of this Article: 6.2. Places a public notice at the parcel and on public roads at a distance of fifty (50) meters from the boundaries of the cadastral parcel for which the Terms of construction are required, whereby: 6.2.1. the notice shall specify the time limit of fifteen (15) days from the date of publication of the notice for commenting on the proposed construction conditions. 6.3. The form of the content of the Public Notice is presented in Annex 4 of this Administrative Instruaction. 7. Within seven (7) days from the receipt of comments, the competent body shall review received remarks and shall publish them in the competent body's website. 8. Within ten (10) days from the completion of the commenting period, the competent body shall provide written responses to all comments received, and shall publish them in competent body's website. 9. Within thirty (30) days time the competent body decides to: 9.1. Approve the terms of construction proposed by the applicant	stanjem, i da će predloženi uslovi izgradnje ispuniti zahteve, koji su predviđeni u stavu 1. ovog člana: 6.2. Postavlja javno obaveštenje u parceli i u javnom putu u razdaljini od pedeset (50) metara od granica parcele za koju se zahtevaju uslovi izgradnje, gde se: 6.2.1. u obaveštenju se navodi vremenski rok od petnaest (15) dana od dana objavljivanja obaveštenja za davanje komentara o predloženim uslovima izgradnje 6.3. Obrazac sadržaja Javnog obaveštenja je predstavljen u Aneksu 4 ovog Administrativnog uputstva. 7. U roku od sedam (7) dana od prijema komentara, nadležni organ razmatra primljene primedbe i postavlja ih na internet stranici nadležnog organa. 8. U roku od deset (10) dana od završetka perioda za komentare, nadležni organ dostavlja pismene odgovore na sve primljene komentare, i postavlja na internet stranici nadležnog organa. 9. U predviđenom roku od trideset (30) dana, nadležni organ odlučuje da: 9.1. Usvaja uslove izgradnje, koji su predloženi od strane podnosioca prijave;
--	---	--


9.2. Përpunoj kushtet ndërtimore të propozuara nga aplikuesi në mënyrë që të jenë në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, duke marrë parasysh natyrën e ndërtimit, komentet e pranuar nga publiku dhe politikat planifikuese relevante që kanë ndikim në marrjen e vendimit, ose	9.2. Process the terms of construction proposed by the applicant so that they comply with paragraph 1 of this Article, taking into account the nature of construction, comments received by the public and relevant planning policies affecting the decision-making, or	9.2. Razmatra uslove izgradnje koji su predloženi od strane podnosioca prijave kako bi bili u skladu sa stavom 1. ovog člana, uzimajući u obzir prirodu izgradnje, primljene komentare od javnosti i relevantnu politiku planiranja koja utiče na donošenje odluke: ili
9.3. Refuzon kërkesën për arsye se kërkesat e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni nuk janë përmbushur.	9.3. Reject the request on the grounds that requirements under paragraph 1 of this Article have not been fulfilled.	9.3. Odbija zahtev iz razloga da nisu ispunjeni uslovi, koji su utvrđeni stavu 1. ovog člana.
10. Organi kompetent për shqyrtim të kërkesës për Kushte Ndërtimore përdor listën kontrolluese sipas Shtojcës nr. 4 të këtij Udhëzimi Administrativ.	10. During the review of the request for the Terms of Construction, the competent body shall make use of the checklist under Annex 4 of this Administrative Instruction.	10. Nadležni organ za razmatranje zahteva o uslovima izgradnje koristi kontrolni spisak prema Aneksu 4 ovog Administrativnog uputstva.
11. Vendimi si dhe përcaktimi i kushteve ndërtimore përcaktohet me shkrim në mënyrë të saktë dhe duke përfshirë diskutimin e faktorëve nga nën paragrafi 9.2. i këtij neni.	11. The Decision and the Terms of Construction shall be defined in writing, accurately, and take due account of discussions on factors listed under sub-paragraph 9.2 of this Article.	11. Odluka kao i utvrđivanje uslova izgradnje utvrđuju se pismeno na precizan način, i uključujući diskusije o faktorima iz podstava 9.2 ovog člana.
12. Organi kompetent publikon Vendimin për Kushte Ndërtimore në ueb faqen e organit kompetent..	12. The Competent Body publishes the Decision on Construction Terms on the website of the competent body.	12. Nadležni organ objavljuje odluku o uslovima izgradnje na internet stranici nadležnog organa.
13. Kushtet ndërtimore të miratuara nga organi kompetent janë të vlefshme për një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor.	13. The Terms of Construction approved by the competent body shall be valid for one (1) year, with the possibility of extension of one (1) additional year, in cases when the existing state of play or the spatial planning document are not subjected to change.	13. Uslovi izgradnje koji su usvojeni od strane nadležnog organa važe za godinu (1) dana, uz mogućnost produženja za još jednu (1) godinu, u slučajevima kada se promenilo postojeće stanje ili dokumenat prostornog planiranja.
14. Vendimi për kushte ndërtimore nuk parandalon organin kompetent që të kërkojë korrigjimin e gabimeve në dokumentacionin ndërtimor dhe të dhënat tjera. Organi	14. The issuance of the Decision on the Terms of Construction shall not prevent the competent body from requesting the correction of errors in construction documents and other	14. Odluka o uslovima izgradnje neće sprečiti nadležni organ da zahteva ispravku grešaka u dokumentaciji izgradnje i druge podatke. Nadležni organ je ovlašćen da suspenduje ili


kompetent është i autorizuar që të pezullojë apo të revokojë vendimin për Kushte Ndertimore në rast se është lëshuar gabimisht apo bazuar në të dhëna jo korrekte, të pasakta dhe të pakompletuara ose në shkelje të ndonjë ligji, rregulloreje, akti nënligjor apo dispozitë të Kodit të Ndërtimit ose normave teknike.	data. The competent body is authorized to suspend or revoke a decision on the Terms of Construction if the same has been rendered erroneously or has been grounded on incorrect, inaccurate, and incomplete data, or if the same is in violation of a law, regulation, bylaw, or provision of Construction Code or technical norms.	ukine odluku o uslovima izgradnje ako je izdat pogrešno, ili na osnovu pogrešnih, netačnih ili nekompletnih podataka, ili kršenjem nekog zakona, uredbе, podzakonskog akta ili odredbe Kodeksa izgradnje ili tehničkih normi.
Neni 11 Taksat 1. Taksa për legalizim të ndërtimeve pa leje të përfunduara, substancialisht të përfunduara apo për punët ndërtimore shtesë për përfundim të ndërtimit llogaritet sipas taksases administrative në fuqi për leje ndërtimore të kategorisë së tretë të ndërtimeve. 2. Pavarësisht paragrafit 1 të këtij neni, nuk kërkohet të paguhen taksat për legalizim për: 2.1. ndërtime të rindërtuara si rezultat i luftës, konfliktit, trazirave shoqërore ose forcës madhore; 2.2. ndërtime të identifikuar në ortofoton zyrtare të vitit 2004. 3. Ndërtimet e përfshira në paragrafin 2 të këtij neni e humbin përjashtimin nga taksat për legalizim nëse përfshihen në listën e rrënimt. 4. Organi kompetent mund t'i lejojë aplikuesit të bëjë pagesat me këste, por	Article 11 Fees 1. The fee for the legalization of constructions that have not been completed, substantially completed or for additional construction works for completion of construction is calculated according to the administrative tax in force for the construction permit of the third category of construction. 2. Notwithstanding paragraphs 1 and 2 of this Article, a legalization fee is not required to be paid for the following constructions: 2.1. reconstructed constructions as a result of war, conflict, social unrest or force majeure; 2.2. constructions identified in the official orthophoto of 2004. 3. Constructions included in paragraph 2. of this Article lose the waiver of fees for legalization if included in the Demolition List. 4. Competent Bodies may allow applicants to make payments over time, but Legalization	Član 11 Takse 1. Taksa za legalizaciju završenih, supstancijalno završenih nezakonito izgrađenih objekata ili za dodatne građevinske radove za završetak izgradnje obračunava se prema važećoj administrativnoj taksi za građevinsku dozvolu treće kategorije građevine 2. Bez obzira na stav 1. ovog člana, ne zahteva se plaćanje takse za legalizaciju: 2.1. rekonstruisane izgradnje kao rezultat sukoba interesa, nemira u društvu ili više sile; 2.2. identifikovane izgradnje u zvaničnom ortofotou iz 2004. godine. 3. Izgradnje iz stava 2. ovog člana ne gube oslobođanje od takse za legalizaciju ako su uključene na listi rušenja. 4. Nadležni organ može odobriti podnosiocu prijave plaćanje na rate, ali Uverenje o

Certifikata e Legalizimit nuk do të jepet pa u paguar shuma e plotë. 4. Taksat zbatohen vetëm për pjesën e ndërtimit pa leje që tejkalon lejen ndërtimore. Megjithatë taksa për leje ndërtimore duhet të paguhet plotësisht para se të jepet legalizimi. 5. Nëse aplikacioni për legalizim është vetëm për ndryshim të përdorimit nga përdorimi i lejuar, organi kompetent do të ngarkojë vetëm taksën për ndryshim të përdorimit, nëse ka. 6. Nëse aplikacioni për legalizim është për ndërhyrje pa leje, taksat do të zbatohen vetëm për pjesën e ndërhyrjes pa leje. 8. Nëse një aplikues ka paguar çfarëdo takse të legalizimit gjatë programeve të mëparshme, këto taksa zbriten nga shuma që duhet paguar sipas Ligjit, edhe pse paratë nuk do të kthehen nëse shuma e paguar sipas ndonjë programi të mëparshëm është më e lartë se sa shuma që duhet paguar.	Certificate will not be granted until the full amount is paid. 5. Fees shall be applied only for the part of construction without permit in excess of the construction permit. However, the construction permit fee must be paid in full before legalization is granted. 6. If a legalization application is only for a change of use from a permitted use, the competent body shall charge only a change of use fee, if any. 7. If a legalization application is for an Intervention without permit, fees shall be applied only for the part of intervention without permit. 8. If an applicant has paid any legalization fees under prior programs, these fees will be deducted from the amount that must be paid under this Law, although no refunds will be given if the amount paid under the prior programs is higher than the amount to be paid.	legalizaciji neće se izdati bez plaćanja celog iznosa. 5. Taksa se primenjuje samo za deo nezakonito izgrađenog objekta koji premašuje građevinsku dozvolu. Međutim taksu za građevinsku dozvolu treba uplatiti u potpunosti pre izdavanja legalizacije. 6. Ako je prijava za legalizaciju samo za promenu korišćenja iz dozvoljenog korišćenja, nadležni organ će zadužiti samo taksu za promenu korišćenja, ako postoji. 7. Ako je prijava za legalizaciju za intervencije uz dozvolu, takse će se primeniti samo za deo intervencije uz dozvolu. 8. Ako je podnosilac prijave uplatio bilo koju taksu za legalizaciju tokom prethodnih programa, ove takse će biti umanjene iz iznosa kojeg treba uplatiti prema ovom zakonu, iako novac neće biti vraćen ako je uplaćen iznos prema prethodnom programu veći od iznosa kojeg treba uplatiti.
Neni 12 Afatet Zbatimi i dispozitave përkatëse për afatet e procedurës së trajtimit të ndërtimeve pa leje bëhet sipas nenit 21 të Ligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje, dhe afateve të përcaktuara me këtë Udhëzimit Administrativ.	Article 12 Time limits The implementation of the relevant provisions on the time limits for the procedure of treatment of illegal constructions, is done according to Article 21 of the Law on illegal constructions treatment and the time limits set out in this Administrative Instruction.	Član 12 Rokovi Primena relevantnih odredaba za rokove postupka za tretman nezakonito izgrađenih objekata vrši se prema članu 21. Zakona o tretiranju nelegalne izgradnje, i rokova koji su utvrđeni ovim Administrativnim uputstvom.

Neni 13 Ankesat ndaj vendimeve të organit kompetent 1. Çdo person fizik ose juridik që ndikohet nga një vendim administrativ i nxjerrë sipas Ligjit ka të drejtë të ushtrojë ankesë ndaj vendimit ose mos veprimit nga organi kompetent. 2. Trajtimi i ankesave ndaj vendimeve të organit kompetent zhvillohet sipas nenit 22 të Ligjit, dhe Udhëzimit Administrativ për Procedurat e Ankesave, për çdo çështje që nuk është paraparë sipas nenit 22 të Ligjit dhe Udhëzimit Administrativ për Procedurat e Ankesave, do të zbatohen dispozitat përkatëse të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative.	Article 13 Appeals against decisions of the competent body 1. Any natural or legal person affected by an administrative decision issued under the Law shall have the right to appeal against a decision of or inaction by the competent body. 2. Handling of appeals against the decisions of the competent body is carried out according to Article 22 of the Law and Administrative Instruction on Appeals Procedures, for any matter not provided in Article 22 of the Law and Administrative Instruction on Appeals Procedures, the relevant provisions of the General Administrative Procedure Law shall apply.	Član 13 Žalbe na odluke nadležnog organa 1. Svako fizičko ili pravno lice na koje utiče administrativno rešenje doneto prema zakonu, ima pravo da uloži žalbu na odluku ili nepostupanje od strane nadležnog organa. 2. Razmatranje žalbi na odluke nadležnog organa, vrši se prema članu 22. zakona, Zakona i Administrativnom uputstvu o žalbenom postupku, za bilo koje pitanje koje nije predviđeno članom 22. Zakona i Administrativnog uputstva o žalbenom postupku, primeniće se relevantne odredbe Zakona o opštem upravnom postupku.
Neni 14 Shtojcat Pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi Administrativ janë Shtojcat 1, 1A, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10.	Article 14 Annexes An integral part of this Administrative instruction are the following Annexes 1, 1A, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 and 10.	Član 14 Aneksi Sastavni deo ovog Administrativnog uputstva su Aneksi 1, 1A, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 i 10.
Neni 15 Hyrja në fuqi Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.	Article 15 Entry into force This Administrative Instruction enters into force seven (7) days after signing by the Minister of Ministry of the Environment and Spatial Planning.	Član 15 Stupanje na snagu Ovo Administrativno uputstvo stupa na snagu sedam (7) dana od dana potpisivanja od Strane Ministra Ministarstva Životne Sredine i Prostornog Planiranja.

Fatmir Matoshi

Ministër i Ministrisë së Mjedisit dhe
Planifikimit Hapësinor
Datë: 08.07 2019

Fatmir Matoshi

Minister of the Ministry of Environment and
Spatial Planning
Date: 08.07 2019

Fatmir Matoshi

Ministar Ministarstva životne sredine i
prostornog planiranja
Dana: 08.07 2019. Godine



Republika e Kosovës
Qeveria e Kosovës
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

SHTOJCA 1.

Formulari standard i aplikimit për certifikatë të legalizimit për kategorinë III
(për ndërtimet e përfunduara ose substancialisht të përfunduara)

Vërejtje: Para aplikimit, pala është e obliguar të konsultohet me Departamentin e Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit në MMPH.

Për plotësim në zyrë (nga MMPH)	
Numri i Referencës:	
Data e pranimit:	

1. Informatat rreth aplikuesit		A është aplikuesi përfaqësues i autorizuar? Jo ☐ Po ☐ Nëse po, aplikimi i bashkëngjitet marrëveshja e noterizuar me pronarin e ndërtimit pa leje.	
Emri:		Nr. i ID:	
Adresa:			
Telefoni:		☐	Kontakti përmes telefonit apo përmes e-mailit?
Emaili:		☐	

2. Informatat rreth pronarit të ndërtimit (Plotësoni të dhënat për personin juridik ose personin fizik)	
<u>Personi juridik</u> (nëse është e zbatueshme)	
Emri:	_____
Adresa:	_____
<u>Personi fizik</u> (nëse është e zbatueshme)	
Emri:	_____ Nr. ID: _____
Adresa:	_____

3. Aplikimi bëhet për (zgjedh njërin opsion):	
Ndërtim të veçantë	☐
Kompleks ndërtimesh	☐
Sistem infrastrukturor	☐

Nëse aplikimi bëhet për më shumë se një ndërtim, vargu i tabelave të plotësuara 4, 5, dhe 6 përsëritet për secilin ndërtim. Dokumentet e kërkuara sipas këtyre tabelave dorëzohen për secilin ndërtim.

4. Detajet rreth ndërtimit			
Adresa e ndërtimit (ose përshkrimi i lokacionit):			
Zona Kadastrale:		Nr. i Parcelës Kadastrale:	
Koordinatat e vendndodhjes GPS:			
Funksioni:			
Ndërtimi:		Ndërtim pa leje ndërtimore ☐ Tejkallim i lejes ndërtimore ☐	
Sipërfaqja bruto e ndërtimit (m ²)	Numri i kateve:	Lartësia (m):	Vlera investive: €

5. Dëshmitë mbi ndërtimin e kryer para datës 05.09.2018:	Po	Jo	N/Aⁱ
a. Ortofoto zyrtare ose fotografi tjera ajrore apo satelitore të realizuara para datës 05.09.2018, në të cilën shihet ndërtimi.	☐	☐	☐
Nëse ekzistimi i ndërtimit nuk mund të vërtetohet sipas pikës a, aplikuesi jep një deklaratë nën betim lidhur me kohën kur është ndërtuar ndërtimi (pika b.), si dhe një nga dëshmitë të listuara nën pikat c, d, ose e.			
b. Deklaratë nën betim lidhur me kohën kur është ndërtuar ndërtimi	☐	☐	☐
c. Prova të pagesës së tatimit në pronë	☐	☐	☐
d. Prova të pagesës së faturave të shërbimeve publike	☐	☐	☐
e. dokument të lëshuar nga një autoritet publik	☐	☐	☐
Në rast të mungesës së dëshmive nën pikat c, d, ose e, aplikuesi sjellë dy nga dëshmitë nën pikat f, g, h, i.			
f. fatura të ndërlidhura për ndërtimin	☐	☐	☐
g. kontratë të ndërlidhura për ndërtimin	☐	☐	☐
h. deklaratë nën betim të një dëshmitari që nuk është i lidhur me aplikuesin, pronarin e ndërtimit pa leje ose investitorin	☐	☐	☐
i. dokument tjetër të besueshëm që dëshmon kohën kur është ndërtuar ndërtimi	☐	☐	☐

6. Dëshmitë mbi të drejtën pronësore ose të drejtën e shfrytëzimit mbi parcelën:	Po	Jo	N/Aⁱ
Kopja e planit dhe certifikata e pronësisë jo më të vjetra se gjashtë muaj. Nëse pronari i ndërtimit pa leje nuk është pronari i regjistruar i parcelës, dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm për të dëshmuar të drejtën pronësore ose të drejtën e shfrytëzimit mbi parcelën.	☐	☐	☐

7. Pëlqimet/lejet për kyçje në infrastrukturë sipas llojit të ndërtimit:	Po	Jo	N/A
a. Pëlqimi për kyçje në ujësjellës dhe kanalizim	☐	☐	☐
b. Pëlqimi për kyçje në rrjetin e energjisë elektrike	☐	☐	☐
c. Pëlqimi nga ZRRE (Zyra e rregullatorit të energjisë)	☐	☐	☐
d. Pëlqimi për vlerësimin e ndikimit në mjedis	☐	☐	☐
e. Leja ujore	☐	☐	☐
f. Pëlqimi për mbrojtjen nga zjarri nga AME (Agjencia për Menaxhim të Emergjencave)	☐	☐	☐
g. Pëlqimi/kyçja në rrugët publike nga Ministria e Infrastrukturës	☐	☐	☐
h. Te tjera	☐	☐	☐

8. Dokumentacioni i kompanisë projektuese që përgatitë prezentimin grafik dhe përshkrimi i gjendjes ekzistuese të ndërtimit pa leje				Po	Jo
a. Certifikata e biznesit				☐	☐
b. Informatat e biznesit				☐	☐
Ekipi hartues					
Inxhinieri i		Telefoni:	Emaili:		
Inxhinieri i ndërtimit:		Telefoni:	Emaili:		
Inxhinieri i		Telefoni:	Emaili:		
Inxhinieri i		Telefoni:	Emaili:		
Inxhinieri i elektrikes:		Telefoni:	Emaili:		
Inxhinier i gjeodezisë:		Telefoni:	Emaili:		
Personi i licencuar- mbrojtja nga zjarri:		Telefoni:	Emaili:		
c. Deklaratë e ekipit hartues				☐	☐
d. Diplomat e ekipit hartues				☐	☐

9. Prezentimi grafik dhe përshkrimi i gjendjes ekzistuese të ndërtimit pa leje	Po	Jo	N/A
a. Përshkrimi teknik: dimensionet e ndërtimit, sipërfaqja bruto, etazhiteti, lartësia e kateve, lartësia e ndërtimit, konstruksioni, funksioni.	☐	☐	☐
b. Situacioni – plani i lokacionit të gjerë me parcelat kadastrale, rrugët dhe ndërtesat ekzistuese, që përfshinë hapësirën brenda pesëdhjetë (50) metrash nga vijat kufizuese të parcelës kadastrale ku gjendet ndërtimi pa leje, e marrë nga ortofoto (Gjeoportali i Agjencionit Kadastral të Kosovës) (1:500 apo 1:1000)	☐	☐	☐
c. Incizimi gjeodezik i planit i parcelës, pozicionimit të ndërtimit pa leje dhe objekteve tjera në parcelë, me dimensione, kuota të lartësisë dhe etazhitet (1:100)	☐	☐	☐
d. Baza e themeleve, kateve dhe kulmit (1:100 ose 1:50)	☐	☐	☐
e. Prerjet gjatësore dhe tërthore (1:100 ose 1:50)	☐	☐	☐

f. Dukjet (1:100 ose 1:50)	☐	☐	☐
g. Fotografitë që prezantojnë dukjet e ndërtimit pa leje (së paku 4), si dhe që prezantojnë ndërtimin pa leje në raport me ndërtesat fqinje – lartësia dhe dukja	☐	☐	☐
h. Raporti i stabilitetit të strukturës - Elementet përbërëse të strukturës dhe struktura në tërësi - Materialet e aplikuara në strukturë - Analizat dhe llogaritjet nga aspekti statik, dinamik dhe sizmik, në raport me rregullore dhe kodet në fuqi	☐	☐	☐
i. Raporti i instalimeve të ujit - Mënyra dhe pozicioni i kyqjes kryesore në ujësjellës dhe kanalizim - Kapacitetet e furnizimit - Pozicioni i njehsorit, kuadrove shpërndarës (foto dëshmi) - Dimensionet dhe materialet e gypave furnizues dhe shkarkues - Largimi i ujërave atmosferik	☐	☐	☐
j. Raporti i instalimeve elektrike - Mënyra dhe pozicioni i kyqjes kryesore në rrjetin distributiv elektroenergjetik - Kapacitetet e furnizimit - Pozicioni i njehsorit, kuadrit kryesor dhe tabelave shpërndarëse (foto dëshmi) - Skema njëpolare të tabelave shpërndarëse dhe kuadrove kryesor shpërndarës	☐	☐	☐
k. Raporti i instalimeve mekanike - Mënyra dhe pozicioni i kyqjes kryesore në rrjetin e ngrohjes - Kapaciteti dhe distribimi i ngrohjes në ndërtim - Ashensorët– Kapaciteti, Raporti teknik - Sistemet/pajisjet/makineritë tjera në ndërtesë (nëse është e aplikueshme) – Kapaciteti, Raporti teknik	☐	☐	☐
l. Elaborat për mbrojtje nga zjarri	☐	☐	☐
m. Qasja për persona me aftësi të kufizuara	☐	☐	☐

10. Deklarata e aplikuesit	
Unë aplikoj për certifikatën e legalizimit të ndërtimit, sipas përshkrimeve në këtë formular dhe në dokumentet përcjellëse, prezentimet grafike dhe informatat shtesë. Konfirmoj se sipas dijenisë sime më të mirë të gjitha faktet të deklaruara në këtë aplikacion janë të vërteta dhe të sakta.	
Nënshkrimi i aplikuesit:	Data (DD/MM/VVVV):
Nënshkrimi i Zyrtarit kompetent:	Data (DD/MM/VVVV):
*** Ju lutemi kërkonte nga Zyrtari/ja fletë-dëshminë për dorëzimin e kësaj kërkesë dhe dokumenteve të bashkangjitura ***	

ⁱ Rubrika "Nuk Aplikohet" (N/A) plotësohet në rastet kur ofruesit e shërbimeve publike nuk ofrojnë shërbime në ato vendbanime si dhe në rastet kur ndonjë kërkesë nuk përkon me llojin e ndërtimit.



Republika e Kosovës
Qeveria e Kosovës
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

SHTOJCA 1A.

Formulari standard i aplikimit për leje legalizimi për përfundim të ndërtimit për kategorinë III
(për ndërtimet e papërfunduara)

Vërejtje: Para aplikimit, pala është e obliguar të konsultohet me
Departamentin e Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit në
MMPH.

Për plotësim në zyrë (nga MMPH)	
Numri i Referencës:	
Data e pranimit:	

1. Informatat rreth aplikuesit		A është aplikuesi përfaqësues i autorizuar? Jo ☐ Po ☐ Nëse po, aplikimit i bashkëngjitet marrëveshja e noterizuar me pronarin e ndërtimit pa leje.	
Emri:		Nr. i ID:	
Adresa:			
Telefoni:		☐	Kontakti përmes telefonit apo përmes e-mailit?
Emaili:		☐	

2. Informatat rreth pronarit të ndërtimit (Plotësoni të dhënat për personin juridik ose personin fizik)	
Personi juridik (nëse është e zbatueshme)	
Emri: _____	
Adresa: _____	
Personi fizik (nëse është e zbatueshme)	
Emri: _____	Nr. ID: _____
Adresa: _____	

3. Aplikimi bëhet për (zgjedh njërin opsion):	
Ndërtim të veçantë	☐
Kompleks ndërtimesh	☐
Sistem infrastrukturor	☐

Nëse aplikimi bëhet për më shumë se një ndërtim, vargu i tabelave të plotësuara 4, 5, dhe 6 përsëritet për secilin ndërtim. Dokumentet e kërkuara sipas këtyre tabelave dorëzohen për secilin ndërtim.

4. Detajet rreth ndërtimit			
Adresa e ndërtimit (ose përshkrimi i lokacionit):			
Zona Kadastrale:		Nr. i Parcelës Kadastrale:	
Koordinatat e vendndodhjes GPS:			
Funksioni:			
Ndërtimi:		Ndërtim pa leje ndërtimore ☐ Tejkallim i lejes ndërtimore ☐	
Sipërfaqja bruto e ndërtimit të përfunduar (m ²)	Numri i kateve të ndërtimit të përfunduar:	Lartësia e ndërtimit të përfunduar (m):	Vlera investive e ndërtimit të përfunduar (€):

5. Dëshmitë mbi ndërtimin e kryer para datës 05.09.2018:	Po	Jo	N/Aⁱ
a. Ortofoto zyrtare ose fotografi tjera ajrore apo satelitore të realizuara para datës 05.09.2018, në të cilën shihet ndërtimi.	☐	☐	☐
Nëse ekzistimi i ndërtimit nuk mund të vërtetohet sipas pikës a, aplikuesi jep një deklaratë nën betim lidhur me kohën kur është ndërtuar ndërtimi (pika b.), si dhe një nga dëshmitë të listuara nën pikat c, d, ose e.			
b. Deklaratë nën betim lidhur me kohën kur është ndërtuar ndërtimi	☐	☐	☐
c. Prova të pagesës së tatimit në pronë	☐	☐	☐
d. Prova të pagesës së faturave të shërbimeve publike	☐	☐	☐
e. dokument të lëshuar nga një autoritet publik	☐	☐	☐
Në rast të mungesës së dëshmive nën pikat c, d, ose e, aplikuesi sjellë dy nga dëshmitë nën pikat f, g, h, i.			
f. fatura të ndërlidhura për ndërtimin	☐	☐	☐
g. kontratë të ndërlidhura për ndërtimin	☐	☐	☐
h. deklaratë nën betim të një dëshmitari që nuk është i lidhur me aplikuesin, pronarin e ndërtimit pa leje ose investitorin	☐	☐	☐
i. dokument tjetër të besueshëm që dëshmon kohën kur është ndërtuar ndërtimi	☐	☐	☐

6. Dëshmitë mbi të drejtën pronësore ose të drejtën e shfrytëzimit mbi parcelën:	Po	Jo	N/Aⁱ
Kopja e planit dhe certifikata e pronësisë jo më të vjetra se gjashtë muaj. Nëse pronari i ndërtimit pa leje nuk është pronari i regjistruar i parcelës, dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm për të dëshmuar të drejtën pronësore ose të drejtën e shfrytëzimit mbi parcelën.	☐	☐	☐

7. Pëlqimet/lejet për kyçje në infrastrukturë sipas llojit të ndërtimit:	Po	Jo	N/A ⁱ
a. Pëlqimi për kyçje në ujësjellës dhe kanalizim	☐	☐	☐
b. Pëlqimi për kyçje në rrjetin e energjisë elektrike	☐	☐	☐
c. Pëlqimi nga ZRRE (Zyra e rregullatorit të energjisë)	☐	☐	☐
d. Pëlqimi për vlerësimin e ndikimit në mjedis	☐	☐	☐
e. Leja ujore	☐	☐	☐
f. Pëlqimi për mbrojtjen nga zjarri nga AME (Agjencia për Menaxhim të Emergjencave)	☐	☐	☐
g. Pëlqimi/kyçja në rrugët publike nga Ministria e Infrastrukturës	☐	☐	☐
h. Te tjera	☐	☐	☐

8. Dokumentacioni i kompanisë projektuese që përgatitë prezentimin grafik dhe përshkrimi i gjendjes ekzistuese të ndërtimit pa leje		Po	Jo
a. Certifikata e biznesit		☐	☐
b. Informatat e biznesit		☐	☐
Ekipi hartues i projektit të ndërtimit të ndërtimit ekzistues pa leje – përfshihen profesionistët sipas kërkesave të aplikueshme për ndërtimin pa leje			
Inxhinieri i		Telefoni:	Emaili:
Inxhinieri i ndërtimit:		Telefoni:	Emaili:
Inxhinieri i		Telefoni:	Emaili:
Inxhinieri i		Telefoni:	Emaili:
Inxhinieri i elektrikes:		Telefoni:	Emaili:
Inxhinier i gjeodezisë:		Telefoni:	Emaili:
Personi i licencuar- mbrojtja nga zjarri:		Telefoni:	Emaili:
c. Deklaratë e ekipit hartues		☐	☐
d. Diplomat e ekipit hartues		☐	☐

9. Prezentimin grafik dhe përshkrimi i gjendjes ekzistuese të ndërtimit pa leje	Po	Jo	N/Aⁱ
a. Përshkrimi teknik: dimensionet e ndërtimit, sipërfaqja bruto, etazhiteti, lartësia e kateve, lartësia e ndërtimit, konstruksioni, funksioni, viti i ndërtimit. Vërejtje: Te ndërhyrjet pa leje të jepet edhe ndërlidhja/impakti në ndërtimin me leje	☐	☐	☐

b. Matjet gjeodezike - Rilevimi gjeodezik i planit të parcelës (duke përfshirë edhe pikat e kyçjes në ujësjellës, kanalizim, furnizim me energji elektrike), - Matja gjeodezike e objektit - ndërtesës (pasqyrim tridimensional - gjeometria e ndërtesës x, y, h) - krijimi i skicave për secilin kat - bodrumit, perdhese dhe kateve të ndërtimit. - krijimi i regjistrit të fletparaqitjes për ndërtesa dhe pjesë të ndërtesës Verejtje: te nderhyrjet pa leje ne ndertimet me leje, incizimi behet per pjesën e nderhyrjes (Matjet e mësipërme gjeodezike bëhen duke iu referuar "Katalogut për matjen dhe krijimin e njësive kadastrale" të nxjerrë na AKK)	☐	☐	☐
c. Fotografitë që prezantojnë dukjet e ndërtimit pa leje (të gjitha fasadat) Verejtje: Te ndërhyrjet pa leje ne ndertimet me leje fotografitë duhet të prezantojnë ndërtesën me leje dhe ndërhyrjen pa leje (të gjitha fasadat), si dhe ndërhyrjen pa leje si të veçantë (të gjitha fasadat)	☐	☐	☐
d. Elaborati i stabilitetit të strukturës (te ndërhyrjet pa leje të jepet struktura e ndërhyrjes pa leje dhe ndikimet në strukturën e ndërtimit me leje) - Elementet përbërëse të strukturës dhe struktura në tërësi - Materialet e aplikuara në strukturë - Analizat dhe llogaritjet nga aspekti statik, dinamik dhe sizmik, në raport me rregullore dhe kodet në fuqi	☐	☐	☐
e. Elaborati i instalimeve të ujit (te ndërhyrjet pa leje të jepen instalimet e ndërhyrjes pa leje dhe ndikimet në instalimet e ndërtimit me leje) - Mënyra dhe pozicioni i kyqjes kryesore në ujësjellës dhe kanalizim - Kapacitetet e furnizimit - Pozicioni i njehsorit, kuadrove shpërndarës (foto dëshmi) - Dimensionet dhe materialet e gypave furnizues dhe shkarkues - Largimi i ujërave atmosferik	☐	☐	☐
f. Elaborati i instalimeve elektrike (te ndërhyrjet pa leje të jepen instalimet e ndërhyrjes pa leje dhe ndikimet në instalimet e ndërtimit me leje) - Mënyra dhe pozicioni i kyqjes kryesore në rrjetin distributiv elektroenergjetik - Kapacitetet e furnizimit - Pozicioni i njehsorit, kuadrit kryesor dhe tabelave shpërndarëse - Skema njëpolare të tabelave shpërndarëse dhe kuadrove kryesor shpërndarës	☐	☐	☐
g. Elaborati i instalimeve mekanike (te ndërhyrjet pa leje të jepen instalimet e ndërhyrjes pa leje dhe ndikimet në instalimet e ndërtimit me leje) - Mënyra dhe pozicioni i kyqjes kryesore në rrjetin e ngrohjes - Kapaciteti dhe distribimi i ngrohjes në ndërtim - Ashensorët– Kapaciteti, Raporti teknik - Sistemet/pajisjet/makinertë tjera në ndërtesë (nëse është e aplikueshme) – Kapaciteti, Raporti teknik	☐	☐	☐
h. Elaborat për mbrojtje nga zjarri	☐	☐	☐
i. Qasja për persona me aftësi të kufizuara	☐	☐	☐

10. Punët e planifikuara ndërtimore	Po	Jo
Për përfundimin e ndërtimit parashihen punë ndërtimore shtesë që ndërrojnë shputën ose lartësinë e ndërtimit, ose e ndryshojnë destinimin ekzistues.	☐	☐
VËREJTJE – MOS e plotësoni tabelën vijuese 10 dhe kaloni në tabelën 11 nëse: - e keni zgjedhur opsionin “jo” në këtë tabelë, ose - ka plan hapësinor që përcakton të gjitha kushtet e ndërtimit të nevojshme për parcelën kadastrale në të cilën dëshironi të përfundoni ndërtimin.		

11. Propozimi i kushteve ndërtimore për përfundimin e ndërtimit të papërfunduar pa leje							
Përshkrimi i mjedisit rrethues dhe ndërtesave							
Ju lutem përshkruani ndërtimet ekzistuese dhe karakteristikat e rrethitës përbrenda pesëdhjetë (50) metrash nga vijat kufizuese të parcelës kadastrale ku aplikuesi propozon të përfundojë ndërtimin pa leje të papërfunduar: a. A ekzistojnë ndërtime në rrethinë përbrenda pesëdhjetë (50) metrash nga vijat kufizuese të parcelës tuaj: PO JO , Nëse PO, Cila Kategori e I II III i b. Përshkruani ndërtimet në rrethinë përbrenda pesëdhjetë (50) metrash nga vijat kufizuese të parcelës tuaj:							
Kushtet e propozuara ndërtimore							
a. Destinimi i propozuar i shfrytëzimit të tokës:ⁱⁱ a.1. Përdorimi i propozuar i ndërtesës							
b. Vija rregulluese (VRR) nga skaji i rrugës publike.”	m’						
c. Vija e ndërtimit (VN) nga kufijtë e parcelës kadastrale kah:							
c.1. Pjesa ballore kah rruga publike	m’						
c.2. Anët – djathtas (AD)	m’						
c.3. Anët – majtas (AM)	m’						
c.4. Pasmë	m’						
d. Lartësia e lejuar në raport me largësinë nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike”	/						
e. Lartësia e lejuar në raport me largësinë nga kufiri anësor (anësor djathtas ndërtimit AD dhe anësor majtas AM) dhe i pasmë (P) të parcelës kadastrale ‘	<table> <tr><td>P</td><td>/</td></tr> <tr><td>AD</td><td>/</td></tr> <tr><td>AM</td><td>/</td></tr> </table>	P	/	AD	/	AM	/
P	/						
AD	/						
AM	/						
f. Përqindja e sipërfaqes të përgjithshme shfrytëzueshme për shputën e ndërtesës kadastrale (Indeksi i Shfrytëzimit të Parcelës Kadastrale për Zhvillim - ISHPKZh)“	%						
g. Përqindja e sipërfaqes së përgjithshme e gjelbërimit për absorbim të reshjeve atmosferike në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale (Sipërfaqja absorbuese gjelbëruese e parcelës SAGJP)“	%						
h. Përqindja e sipërfaqes së përgjithshme e ndërtimit brenda parcelës kadastrale në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale (Indeksi i Sipërfaqes së Ndërtuar - ISN)“							

i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale Sipërfaqja nëntokësore e parcelës (SNP) ^{xs}	%
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve	
k. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtimit:	
l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po ☐ Jo ☐ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe se sa zona përreth? Po ☐ Jo ☐ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të Veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po ☐ Jo ☐ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:	
o. Tjetër:	
Projekti Konceptual për përfundimin e ndërtimit të papërfunduar pa leje Po ☐ Jo ☐	

12. Deklarata e aplikuesit	
Unë aplikoj për lejen e legalizimit për përfundim të ndërtimit, sipas përshkrimeve në këtë formular dhe në dokumentet përcjellëse, prezentimet grafike dhe informatat shtesë. Konfirmoj se sipas dijenisë sime më të mirë të gjitha faktet të deklaruar në këtë aplikacion janë të vërteta dhe të sakta. Jam i njohur se ky aplikim mund të konsiderohet i kompletuar vetëm pasi që ta dorëzoj edhe projektin kryesor për përfundimin e ndërtimit, sipas kushteve ndërtimore të miratuara nga Organi Kompetent.	
Nënshkrimi i aplikuesit:	Data (DD/MM/VVVV):
Nënshkrimi i Zyrtares kompetent: (pranimi i dokumenteve të aplikacionit para dorëzimit të projektit kryesor)	Data (DD/MM/VVVV):
Nënshkrimi i Zyrtares kompetent pas kompletimit të aplikacionit:	Data (DD/MM/VVVV):
Vërejtje: Para aplikimit për legalizim, aplikuesi duhet të konsultohet me Ligjin Nr. xxxx për trajtimin e ndërtimeve pa leje dhe këtë UA se cilat dokumentacione janë të nevojshme për aplikim, apo mund të kërkojë sqarime në Komunë.	
*** Ju lutemi kërkonte nga Zyrtari/ja fletë-dëshminë për dorëzimin e kësaj kërkesë dhe dokumenteve të bashkangjitura ***	


¹ Rubrika "Nuk Aplikohet" (N/A) plotësohet në rastet kur ofruesit e shërbimeve publike nuk ofrojnë shërbime në ato vendbanime si dhe në rastet kur ndonjë kërkesë nuk përkon me llojin e ndërtimit.

¹ Nëse ekzistojnë të gjitha kategoritë e ndërtimeve atëherë i shënoni të gjitha.

¹ Nëse destinimi i shfrytëzimit të tokës tashmë është vendosur për parcelën kadastrale që është objekt i kësaj kërkesë, atëherë shënoni destinimin e vendosur. Nëse nuk ka destinim të shfrytëzimit të tokës, atëherë aplikuesi duhet të propozojë një destinim bazuar në shfrytëzimin e dëshiruar të parcelës. Nëse destinimi i shfrytëzimit të tokës tashmë është vendosur, por destinimi i vendosur është i ndryshëm nga destinimi i dëshiruar, aplikuesi së pari duhet të ndjekë metodat në dispozicion sipas ligjeve tjera për të ndryshuar destinimin e shfrytëzimit të tokës. Ky formular NUK MUND të përdoret për të propozuar ndryshimin e destinimit të shfrytëzimit të tokës.

¹Vija Rregulluese (VRR):

Shih diagramin e mëposhtëm për sqarime lidhur me Vijën Rregulluese, që shënon distancën prej rrugës publike e cila rezervon hapësirë për shërbime publike dhe infrastrukturë tjetër, dhe Vijat e Ndërtimit që shënojnë distancën nga skajet e parcelës kadastrale prej të cilave duhet të tërhiqen ndërtimet për përfundimin e ndërtimit të papërfunduar pa leje.



¹Lartësia në raport me rrugën publike: paraqet lartësinë maksimale të lejuar në raport me largësinë nga kufiri i parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike. Raporti i lartësisë ndaj rrugës publike është raport i lartësisë me gjerësinë, ndaj të cilës lartësia e ndërtesës nuk lejohet të depërtojë, dhe është projektuar për të siguruar dritë dhe ajër në nivel të rrugës publike.

¹Lartësia në raport me kufijtë e parcelës: paraqet lartësinë maksimale të lejuar në raport me largësinë nga kufijtë anësorë dhe të pasmë të parcelës kadastrale për zhvillim. Raporti i lartësisë është raporti i lartësisë së ndërtesës në anët anësore apo të pasme në raport me lartësitë e ndërtesave përballë, ndaj të cilës lartësia e ndërtesës nuk lejohet të depërtojë, dhe është projektuar për të siguruar dritë dhe ajër ndërmjet pronave fqinje.

¹Indeksi i Shfrytëzimit të Parcelës Kadastrale për Zhvillim (ISHPKZh): paraqet raportin mes sipërfaqes së shputës së ndërtesës dhe sipërfaqes së parcelës kadastrale për zhvillim, shumëzuar me numrin 100. Ky indeks përcaktohet si përqindje.

¹Sipërfaqja gjelbëruese e absorbuese e parcelës (SGJAP): paraqet raportin mes sipërfaqes së gjelbëruese dhe absorbuese dhe sipërfaqes së parcelës kadastrale për zhvillim shumëzuar me 100. Kjo përqindje mund të jepet si vlerë e vetme e përqindjes së SGJAP apo si shumë e kalkuluar nga shuma e përqindjes së sipërfaqes gjelbëruese të parcelës dhe përqindjes së sipërfaqes absorbuese të parcelës.

¹Indeksi i Sipërfaqes së Ndërtuar (ISN): paraqet raportin mes sipërfaqes së përgjithshme të ndërtimit (shuma e sipërfaqeve të të gjitha kateve të ndërtuara) brenda parcelës kadastrale dhe sipërfaqes së parcelës kadastrale për zhvillim. Ky indeks përcaktohet si vlerë numerike.

¹Sipërfaqja nëntokësore e parcelës (SNP): paraqet përqindjen e sipërfaqes nëntokësore të shfrytëzueshme në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale për zhvillim.



Republika e Kosovës
Qeveria e Kosovës
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

SHTOJCA 2.

Shqyrtimi i aplikacioneve për legalizmin e ndërtimeve të kategorisë III

Për plotësim në zyrë (nga MMPH)	
Numri i Referencës:	
Data e pranimit:	

1. Zyrtari i autorizuar:	
Data e shqyrtimit të aplikacionit	

2. Emri dhe mbiemri i aplikuesit	
----------------------------------	--

3. Detajet rreth ndërtimit			
Adresa e ndërtimit (ose përshkrimi i lokacionit):			
Zona kadastrale:		Nr. i Parcelës Kadastrale:	
Koordinatat e vendndodhjes GPS:			

4. Shqyrtimi i aplikacionit	Po	Jo	N/A ⁱ
Koha e ndërtimit			
a) ndërtimi është bërë pas datës 05.09.2018;	☐	☐	
Pronësia dhe zona në të cilën është bërë ndërtimi			
b) ndërtimi është në pronë publike	☐	☐	☐
c) ndërtimi është në pronë shoqërore	☐	☐	☐
d) ndërtimi është në toka bujqësore nën komasacion dhe nën sistem të ujitjes	☐	☐	☐
e) ndërtimi është në sipërfaqet e mbrojtura, dhe/ose zonat e mbrojtura, dhe/ose zonat e veçanta të mbrojtura, dhe/ose zonat e veçanta, përfshirë parqet kombëtare	☐	☐	☐
f) ndërtimi është në korridoret infrastrukturore	☐	☐	☐
g) ndërtimi është në pronë private, por pronari i ndërtimit nuk posedon dokumentacionin e nevojshëm për të dëshmuar se e posedon të drejtën pronësore ose të drejtën e shfrytëzimit mbi parcelën ndërtimore	☐	☐	☐


Lista kontrolluese në vijim zbatohet vetëm për ndërtimet e papërfunduara (aplikimet përmes shtojcës 1A), nëse:

- për përfundimin e ndërtimit nevojiten punë ndërtimore shtesë që ndërrojnë shputën ose lartësinë e ndërtimit, dhe
- nuk ka plan hapësinor përcakton të gjitha kushtet e ndërtimit të nevojshme për parcelën kadastrale në të cilën gjendet ndërtimi për të cilin dorëzohet aplikacioni.

Lista kontrolluese për shqyrtimin e Kushteve Ndërtimore për përfundimin e ndërtimeve të papërfunduara pa leje				
	Po	Jo	N/A	Nëse jo, çfarë ndryshime kërkohen?
1. A ka plan hapësinor ekzistues, ligj apo akt nënligjor që përcakton ndonjë nga kushtet e ndërtimit të propozuara nga aplikuesi për përfundimin e ndërtimit të papërfunduar pa leje në parcelën kadastrale? Nëse po, kushtet e ndërtimit të cekura në kontrollin e dokumentit ekzistues të planifikimit hapësinor,	☐	☐	☐	
2. A janë kushtet e ndërtimit në vijim të njëjta sikurse ndërtesat ekzistuese brenda diametrit prej pesëdhjetë (50) metrash nga vijat e kufirit të parcelës kadastrale?				
a. Destinimi i shfrytëzimit të tokës	☐	☐	☐	
b. Vija rregulluese	☐	☐	☐	
c. Vija e ndërtimit	☐	☐	☐	
d. Lartësia e lejuar në raport me largësinë nga kufiri i parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	☐	☐	☐	
e. Lartësia e lejuar në raport me distancën nga kufijtë anësor dhe të pasmë të parcelës kadastrale AD; AM; AP	☐	☐	☐	
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale	☐	☐	☐	
g. Përqindja e sipërfaqes së përgjithshme se gjelbëruar në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale	☐	☐	☐	
h. Përqindja e sipërfaqes bruto banuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	☐	☐	☐	
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	☐	☐	☐	
j. Kërkesat minimale për vendparkime të veturave	☐	☐	☐	
k. Materialet e lejuara në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave	☐	☐	☐	
3. A janë propozuar masa të pranueshme për qasje të pakufizuar në rrugët dhe infrastrukturën publike?	☐	☐	☐	

4. A janë propozuar kufizime të pranueshme të ndotjes së ajrit dhe zhurmës në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi?	☐	☐	☐	
5. A janë propozuar masa të pranueshme për mbrojtjen e vlerave natyrore, historike dhe kulturore?	☐	☐	☐	
6. A janë masat për mbrojtje nga zjarri në pajtueshmëri me kërkesat e vendosura nga Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave?	☐	☐	☐	
Komente:				

<u>Përfundimi i shqyrtimit</u>		
☐ Për inspektim të kërkesave themelore për shëndet dhe siguri	☐ Për përfshirje në listën e pritjes	☐ Për përfshirje në listën e rrënimit
<i>Me nënshkrim të këtij dokumenti, zyrtari kompetent vërteton se ky vendim u mor në mënyrë të paanashme dhe cdo informatë e përfshirë në këtë formular është e saktë.</i> Nënshkruar nga zyrtari kompetent: _____ Data: _____		



Republika e Kosovës
Qeveria e Kosovës
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

SHTOJCA 3.
INSPEKTIMI I KËRKESAVE THEMELORE PËR SHËNDET DHE SIGURI

Për plotësim në zyrë (nga MMPH)	
Numri i Referencës	
Data e pranimit:	

1. Emri dhe mbiemri i inspektorit:	
Data e inspektimit:	

2. Emri dhe mbiemri i aplikuesit	
----------------------------------	--

3. Detajet rreth ndërtimit			
Adresa e ndërtimit (ose përshkrimi i lokacionit):			
Zona Kadastrale:		Nr. i Parcelës Kadastrale:	
Koordinatat e vendndodhjes GPS:			

	PO	JO	NA	Vërejtjet/Komentet
4. Gjendja ekzistuese e ndërtimit pa leje nuk ndryshon nga ajo e prezantuar në dokumentet e aplikimit (lokacioni, situacioni, plani i parcelës, etazhiteti, planimetritë, prerjet, dukjet, etj.)	☐	☐	☐	
5. Struktura/Elementet konstruktive të ndërtesës: a. Në shikim gjendja ekzistuese e ndërtesës është identike me raportin e stabilitetit të strukturës të prezantuar.	☐	☐	☐	
6. Uji dhe Kanalizimi:				

a. Në shikim gjendja ekzistuese e ndërtesës është identike me raportin e instalimeve të ujit, duke përfshirë: • Ka kyçje në rrjetin ujësjiellësit, • Uji sigurohet përmes pusit ose burimit tjetër. • Ka kyçje në rrjetin e kanalizimit, • Rrjeti i kanalizimit të jetë i sigurt përmes largimit të përshtatshëm dhe të sigurt të ujerave të zeza me grova septike apo mënyra tjera të sigurta. • Largimi i ujërave atmosferik është zgjedhur në mënyrë të përshtatshme dhe nuk cenon ndërtesat dhe hapësirat në fqinjësi.	☐	☐	☐	
7. Elektri: a. Ka kyçje në rrjetin elektrik. b. Kabllot e dukshme janë në gjendje të rregullt dhe jo të zbuluara.	☐	☐	☐	
8. Instalimet makinerike				
9. Zjarri: a. Projekti për mbrojtje nga zjarri korresponndon me gjendjen në teren. b. Ndërtesa shumëkatëshe rezidenciale dhe/ose komerciale ka: i. Qasje për automjetet e zjarrfikësve se paku tri (3) metra gjerësi për rrugë një kahore ose 5.5 metra gjerësi për rrugë dy kahore; ii. Hidrantët për shuarjen e zjarrit të instaluar dhe funksionale në çdo kat; iii. Shenjëzimet adekuate për rrugët për evakuim; iv. Ndriçimin emergjent; v. Rruga e evakuimit për këmbësor jashtë ndërtimit, është së paku një metër e gjysme (1.5) gjerësi;	☐	☐	☐	

c. Ndërtesa shumëkatëshe rezidenciale dhe/ose komerciale duke përfshirë kufijtë e jashtëm të ndërtesës si konzolla, ballkoni, streha e kulmit etj., është e larguar në distancë më të ≤ 1.5 metër nga ndërtimi fqinj: i. Nuk ka dritare, dyer, ballkone apo hapje të ngjashme; ii. ka marrëveshje në mes fqinjëve për hapje të orientuara nga ndërtimi fqinj e vërtetuar nga noteri.	☐ ☐	☐ ☐	☐ ☐	
d. Ndërtesa shumëkatëshe rezidenciale dhe/ose komerciale duke përfshirë kufijtë e jashtëm të ndërtesës si konzolla, ballkoni, streha e kulmit etj., është e larguar në mes 1.5 deri 3.0 metër nga ndërtimi fqinj: i. nuk ka dritare tjera, përveç atyre në banjo apo shkallë në murin e ndërtesës afër fqijut; ii. ka marrëveshje për hapjet tjera në mes fqinjëve e vërtetuar nga noteri.	☐ ☐	☐ ☐	☐ ☐	

☐ Lejohet. Ndërtimi i plotëson kërkesat themelore të Shëndetit dhe Sigurisë: ☐ për lëshimin e certifikatës së legalizimit, ose ☐ për hartimin e projektit për përfundimin e ndërtimit	☐ Nuk Lejohet Aplikuesi duhet të i përmirësoj dhe plotësoj te gjitha vërejtjet dhe mospërputhjet. Deri sa nuk te plotësohen te gjitha kërkesat ndërtesa/ndërtimi nuk mund te legalizohet. ☐ Aplikuesi pranoi kopjen e këtij dokumenti ☐ Aplikuesi pranoi sqarimet për te drejtat e tij Nënshkrimi i aplikuesit _____
Me nënshkrim të këtij dokumenti, zyrtari kompetent vërteton se ky vendim u mor në mënyrë të paanashme dhe cdo informatë e përfshirë në këtë formular është e saktë. Nënshkrimi i zyrtarit kompetent: _____ Data: _____	



Republika e Kosovës

Qeveria e Kosovës

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Njoftim Publik – Propozimi për Kushte Ndërtimore për përfundimin e ndërtimit

Zbatohet për ndërtimet e papërfunduara pa leje nëse:

- për përfundimin e ndërtimit nevojiten punë ndërtimore shtesë që ndërrojnë shputën ose lartësinë e ndërtimit, dhe
